



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 45
Prishtinë, më 22. 10. 2009, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Morën pjesë: Ismet Beqiri – kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviq,
Nerxhivane Dauti, Sanije Aliaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Naim Rustemi,
Danush Ademi dhe Shpresa Murati.

Mbledhjen e mbikëqyrën: Elita Vokshi dhe Lejla Selimi – OSBE, Rrezarta
Ahmeti – KDI, Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit dhe Arben Malva Govori – ECLO.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator, zyrtar i lartë
dhe Visar Krasniqi - zyrtar ligjor.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet, në bazë të Rregullores së punës të
Kuvendit të Republikës së Kosovës, për mbajtjen e dëgjimit publik dhe propozoi
këtë:

R E N D D I T E

- 1 Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 15. 9. 2009 dhe më 7.10. 2009,
- 2 Nxjerrja e rekomandimeve të dala nga dëgjimi publik i mbajtur më 7.10. 2009
- 3 Shqyrtimi i ankesës së B. Sh., T. R. dhe Gj. D.
- 4 Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 15. 9. 2009 dhe më 7.10. 2009**

Komisioni i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 15.9.2009 dhe më 7.10.2009.

2. Nxjerrja e rekomandimeve të dala nga dëgjimi publik mbajtur më 7.10.2009.

Kryetari i përshëndeti të pranishmit dhe sqaroi se qëllimi i dëgjimit është ta sensibilizojë dhe ta ndihmojë punën në zbardhjen e fatit të të pagjeturve, numri i të cilëve nuk është i vogël. Motivi i dëgjimit publik, ishte t'i riafirmonim dhe t'i fuqizonim përpjekjet e përbashkëta, që procesi i identifikimit të mbetjeve mortore të ecë më tej. Ne jemi të vetëdijshëm se vështirësitë në këtë proces kanë qenë dhe mbesin të mëdha. Por, ne duam që familjarët të informohen qartë për vështirësitë, për procesin dhe për ngecjen e tij, prandaj propozoj që kjo pikë të shtyhet, sepse disa shoqata kanë paralajmëruar se do t'i paraqesin vërejtjet me shkrim.

Komisioni u pajtua me propozimin e kryetarit, që në njërin nga mbledhjet e radhës të nxirren rekomandimet.

3. Shqyrtimi i ankesave

Kryetari e ftoi raportuesen ta merrte fjalën dhe t'i njoftonte anëtarët e Komisionit për përmbajtjen e ankesave.

Nerxhivane Dauti, në cilësi të raportueses tha se ankesat i ka shqyrtuar me kujdes dhe theksoi se B. Sh. pa bazë juridike, me vendimin nr. 313 të datës 11. 09. 2009, e ka suspenduar nga puna Shërbimi Doganor.

Ai konsideron se me këtë veprim organi doganor i ka shkelur liritë dhe të drejtat ligjore, të parapara në Kodin doganor dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Pas shqyrtimit të ankesës, Komisioni i rekomandon B. Sh. që për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës t'u drejtohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, si dhe gjykatës kompetente.

T. R. dhe Gj. D. G. nga Janoshi i Gjakovës - Kërkojnë nga institucionet e Republikës së Kosovës ndalimin e ndjekjes së kundërligjshme të D. G. për shkak të vrasjes së mësuesit të vajzës se tij në Zvicër, që më parë e kishte dhunuar mizorisht.

Ai i lut institucionet shtetërore të marrin masa të nevojshme ligjore për t'i pengua rrëmbimin dhe ekstradimin e kundërligjshëm të tij për vuajtjen e dënimit në shtetin ku e ka bërë krimin dhe ku është dënuar.

Komisioni u rekomandon T. R. dhe Gj. D. G. që t'i drejtohen Ministrisë së Drejtësisë dhe të kërkojnë informata.

4. Të ndryshme

Elita Vokshi – OSBE, e njoftoi Komisionin për nevojën e vizitës zyrtare të anëtarëve të Komisionit në Poloni, që do të realizohet ne fillim te muajt dhjetor 2009. Ajo kërkoi të kryhen formalitetet procedurale për sigurimin e vizave dhe të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit të Republikës, t'ua lejojë vizitën zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

Komisionin e përbëjnë këta anëtarë: Ismet Beqiri, Hajredin Hyseni, Radmilla Vujoviç, Nerxhivane Dauti, Naim Rustemi, Sanije Aliaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati, ndërsa nga stafi i administratës, Rrahim Demaj, koordinator - zyrtar i lartë ligjor dhe Visar Krasniqi – zyrtar ligjor.

Mbledhja përfundoi
në orën 14: 00

Kryetar i Komisionit

Ismet Beqiri